

# TRANZICIONI I DREJTË I ENERGJISË NË KOSOVË - SI TË PROJEKTOHET DHE SI TË ARRIHET?

07/2022



**Programi:**                    **Zhvillim i qëndrueshëm**

**Publikimi:**                **Qershor 2022**

**Foto e ballinës:**        **Unsplash**

---

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

---

Ky punim është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe implementuar nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Energjisë në Kosovë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve. Ato nuk pretendojnë të reflektojnë mbi mendimet ose pikëpamjet e GIZ.

## Përmbajtja

Hyrje .....	2
Metodologjia.....	4
I. Tranzicioni i drejtë i energjisë dhe Kosova .....	5
Definimi i konceptit dhe shtrimi i problemit.....	10
II. Shtyllat kryesore të tranzicionit të drejtë në Kosovë.....	11
Prodhimi i energjisë në Kosovë.....	13
Rrjeti dhe tregu.....	15
Konsumi i energjisë në Kosovë.....	17
III. Rasti i studimit të Suedisë drejt tranzicionit të drejtë energjetik .....	18
IV. Implikimet financiare të tranzicionit të drejtë energjetik.....	22
Mekanizmat fiskal dhe ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të financimit .....	24
Instrumentet e BE-së (IPA III, Fondi i Gjellbër i Klimës dhe Fondi për Tranzicionin e Drejtë) .....	25
Përfundime.....	27
Rekomandime.....	29

## Hyrje

Energjia është një nga fushat më të rëndësishme të jetesës. Me zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin e të gjithë sektorëve që ndikojnë në mbarëvajtjen e jetesës, energjia luan rol kyç, pasi që pa të thuhet çdo gjë është jofunksionale. Në këtë drejtim, me avancimin e sektorëve të tjerë, ka avancuar edhe sektori i energjisë elektrike, duke ditur se tashmë kemi diversifikim të prodhimit të energjisë elektrike dhe më globi nuk bazohet vetëm në burimet konvencionale apo ndryshe të njohura si burime fosile. Një gjë e tillë ka ardhur si rrjedhojë e ndikimit që dora e njeriut i ka shkaktuar mjedisit dhe gjallesave që jetojnë në të, tash e disa shekuj.

Gjatë viteve në vijim, çdo aspekt i sistemeve kombëtare të energjisë do të ndikohet nga ndryshimet në politikat klimatike dhe energjetike, nga financimet e avancimi i vazhdueshëm teknologjik dhe ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për energji. Kostot në rënie të shpejtë të teknologjive të bazuara në burime të ripërtëritshme kanë hapur mundësi të paimagjinuara më parë në të gjithë globin. Zhvillimet e vazhdueshme dhe përditësimi i teknologjisë prodhuese në shumë vende ofrojnë një perspektivë premtuese për sigurinë, gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë e një sektori të transformuar të energjisë. Megjithatë, tranzicioni duhet të përshpejtojë ndjeshëm dhe të zgjerojë fushëveprimin e tij për të arritur Objektivin e shtatë të Agjendës 2030 për Zhvillimet të Qëndrueshëm<sup>1</sup> dhe për t'u përafuar me qëllimet e Marrëveshjes së Parisit<sup>2</sup> për ndryshimet klimatike, duke arritur në të njëjtën kohë zbatimin e plotë të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Kështu, tranzicioni i energjisë nuk mund të kufizohet më në hapa rritës dhe gjithëpërfshirës. Ajo duhet të bëhet një përpjekje transformuese, një rinovim i sistemit, i bazuar në përmirësimin dhe zbatimin e shpejtë të të gjitha teknologjive të disponueshme për të përmirësuar dhe siguruar të ardhmen. Ky është momenti i duhur për të rivlerësuar supozimet e vjetra, barrierat e perceptuara dhe vendimet që na udhëheqin drejt dështimit. Sistemi energjetik në zhvillim duhet të promovojë ekonomi dhe shoqëri që adaptohet për një botë më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Veprimet ambicioze dhe të synuara nevojiten tani dhe gjatë viteve të ardhshme për të siguruar që objektivat dhe targetet për një të ardhme të pastër, të gjelbër, të përballueshme dhe të qëndrueshme të jenë të arritshme.

Tranzicionet e energjisë kanë të bëjnë me njerëzit, pra me ata që marrin vendimet dhe ata që preken nga ato vendime. Një tranzicioni i drejtë siguron që njerëzit e prekur të merren parasysh nga ata që marrin vendime. Kështu që përpos transformimit të sektorit të energjisë dhe orientimit të tij drejt burimeve të cilat nuk emetojnë gazra serrë në atmosferë, një tranzicion i drejtë përfshinë edhe parimin që të mos lihet askush mbrapa. Pra gjithëpërfshirja është element kyç në ndërtimin e një sektorit energjetik të mirë strukturuar dhe të qëndrueshëm, me çmime të përballueshme për të gjithë dhe furnizim të pandërprerë.

---

<sup>1</sup> Kombet e Bashkuara, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, Zhvillimi i qëndrueshëm, e qasshme në <https://sdgs.un.org/goals>, (qasur në maj, 2022)

<sup>2</sup> Kombet e Bashkuara, Marrëveshja e Parisit, e qasshme në [https://unfccc.int/sites/default/files/english\\_paris\\_agreement.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/english_paris_agreement.pdf), (qasur në maj, 2022)

Veprimet e hershme për një tranzicion të drejtë mund të minimizojë ndikimet negative të këtij procesi dhe të maksimizojë mundësitë pozitive. Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike përfshin tranzicionin e drejtë si një parim shumë të rëndësishëm. Tranzicioni i drejtë nuk është një grup rregullash fikse, por një vizion dhe një proces i bazuar në dialog dhe në një agjendë të përbashkët nga punëtorët, industria dhe qeveria që duhet të negociohen dhe zbatohen në kontekstet e tyre gjeografike, politike, kulturore dhe sociale. Ai zbatohet me një sërë parimesh udhëzuese, të cilat parandalojnë shkeljen e të drejtave dhe mundësojnë përfshirjen e gjithësecilit.

Kosova dhe sistemi i saj energjetik kanë nevojë për transformim, duke marrë për bazë se si shtet jemi nënshkruar të Deklaratës së Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020<sup>3</sup>, e gjithashtu jemi zotuar që të zbatojmë të gjitha obligimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Krahas këtyre zotimeve, Kosova synon një të ardhme e cila është në të njëjtin hap me zhvillimet dhe avancimet teknologjike, duke mundësuar të ardhme të pastër dhe të qëndrueshme dhe e cila siguron furnizim të plotë me energji elektrike për të gjithë qytetarët e saj. Duke anuar nga politikat e gjelbra dhe dekarbonizimi i plotë deri në vitin 2050, atëherë tranzicioni i drejtë energjetik aq sa është detyrë dhe obligim, është edhe domosdoshmëri që do të duhet të shtyhet përpara në aspekte të menjëhershme.

Energjia elektrike e gjeneruar nga burimet e ripërtërishme dhe eficienta e energjisë janë e ardhmja e pashmangshme dhe e duhur e sektorit të energjisë elektrike jo vetëm në Kosovë, por në tërë globin.<sup>4</sup> Energjia e ripërtërishme është zgjedhja e pashmangshme për rritjen e qëndrueshme ekonomike, për bashkëjetesën harmonike të njerëzve dhe mjedisit si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo nënkupton që distancimi nga thëngjilli, si burimi kryesor aktualisht për gjenerimin e energjisë elektrike në vendin tonë<sup>5</sup>, të bëhet në hapa të përshpejtuar dhe të konsoliduar krahas politikave që mbështesin qytetarët e Kosovës.

Ky studim politikash veçon rëndësinë e tranzicionit energjetik në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Gjithashtu shpërfaq sfidat dhe mundësitë për të ardhmen, duke ditur se si proces, tranzicioni energjetik praktikisht është i pashmangshëm. Studimi përmabn gjetjet dhe pikat më të ndjeshme që ka sektori i energjisë në vendin tonë, sjell rekomandime në mënyrë që të arrijmë një tranzicion të drejtë, e gjithashtu ofron edhe shembuj të vendeve tjera dhe rrugës së ndjekur nga ana tyre për përmbushjen e një procesi kaq të rëndësishëm.

---

<sup>3</sup> Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e qasshme në [file:///C:/Users/Hp/Downloads/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Hp/Downloads/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB%20(1).pdf), (qasur në maj, 2022)

<sup>4</sup> Just Energy, 7 Llojet e Energjisë së Rinovueshme: E ardhmja e Energjisë, e qasshme në <https://justenergy.com/blog/7-types-renewable-energy-future-of-energy/>, (qasur në maj, 2022)

<sup>5</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Publikimet, Raportet Vjetore, Raporti Vjetor 2021, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021\\_ZRRE\\_Shqip.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021_ZRRE_Shqip.pdf), (qasur në maj, 2022)

## Metodologjia

Për hartimin e këtij punimi është përdorur metodologji e përzier, kualitative dhe kuantitative. Në pjesën ku është përdorur hulumtimi kuantitativ, INDEP përmes metodës së monitorimit, analizimit dhe hulumtimit në tavolinë ka mbledhur të dhëna dhe informata rreth sektorit të energjisë në Kosovë, procesit të tranzicionit energjetik dhe dokumenteve të cilat lidhen me këtë proces. Duke filluar me hulumtimin në tavolinë, kjo metodë kontribuoi në mbledhjen e të dhënave në shkallë globale, por edhe për sfondin e Kosovës në aspektin e energjisë. Në këtë proces u përcaktuan sfidat, problemet dhe mundësitë e transformimit të sektorit të energjisë, duke ofruar kushte të përshtatshme dhe duke mos diskriminuar asnjë qytetar të Kosovës.

Krahas kësaj në mënyrë që ky punim të jetë sa më i plotë, INDEP ka plotësuar gamën e informatave kuantitative edhe përmes hulumtimit kualitativ. Më specifikisht, metodat e përzgjedhura për hartimin e këtij punimi janë studimet e rasteve, mbledhja e të dhënave dhe raportimi i hulumtimeve të INDEP. E gjitha kjo në mënyrë që studimi të jetë sa më i plotë dhe i përshtatshëm me rrethanat në të cilat gjendet Kosova.


Rekomandimet që kemi listuar në fund të studimit do të shpalosin nevojat që Kosova ka krahas procesit të tranzicionit të drejtë energjetik. Rekomandimet janë përmbledhur pas shqyrtimit të praktikave të mira të ndjekura nga vendet tjera, duke i përshtatur ato me situatën dhe kushtet ekonomike që vendi ynë mund të ofrojë. E gjitha kjo duke pasur për bazë zhvillimin e qëndrueshëm, gjelbërimin e sektorit energjetik dhe ofrimin e kushteve të reja dhe të mira për të gjithë popullësinë e Kosovës.



## I. Tranzicioni i drejtë i energjisë dhe Kosova

Zhvillimi i hovshëm teknologjik, shtimi i popullësisë dhe rritja e konsumit kanë ndikuar direkt në ngritjen e kërkesës për sasi të energjisë elektrike. Në aspektet sociale, mjedisore dhe shëndetësore, konsumi i shtuar i energjisë elektrike ka ndikuar negativisht, duke ditur se energjia elektrike tradicionale është prodhuar nga burimet fosile dhe sasi e konsiderueshme e gazrave serrë është liruar nga procesi i prodhimit të saj. Si pasojë e emetimit të gazrave serrë dhe efektit të bllokimit të nxehtësisë që vjen nga këto gazra, sot në botë kemi ngritje të temperaturave të tokës, shkërrime të akullnajave, qarje të shtresës së ozonit, sëmundje vdekjeprurëse, probleme sociale, ndotje të theksuar të ambientit dhe ndryshime klimatike të cilat mund të sjellin edhe efekte tjera negative në të ardhmen.

Deri në mesin e shekullit të 19-të, biomasa tradicionale, pra djegia e lëndëve djegëse të ngurta si druri, mbeturinat e të korrave ose qymyri, ishin burimi kryesor për prodhimin e energjisë elektrike të përdorur në të gjithë botën.<sup>6</sup> Me Revolucionin Industrial erdhi rritja marramendëse e përdorimit të qymyrit. Nga fillimi i shekullit të 20-të, rreth gjysma e energjisë së botës prodhohej nga qymyri dhe gjysma prodhohej ende nga biomasa. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur të dhëna globale sa i përket konsumit të energjisë elektrike për gjatë 70 viteve të fundit.



**Grafiku 1.** Të dhëna mbi konsumin global të energjisë elektrike sipas burimit të prodhimit 1950-2019, **Burimi:** Our World in Data

<sup>6</sup> Our World in Data, Prodhimi dhe Konsumi i Energjisë, Sa energji harxhon bota?, e qasshme në <https://ourworldindata.org/energy-production-consumption>, (qasur në qershor, 2022)

Nga grafiku vërehet që burimet fosile ende janë në një shkallë shumë të lartë të përdorimit dhe ende shkaktojnë dëme të cilat do të paraqiten edhe pas shumë dekadave pasardhëse. Pasojat e tilla kanë shtyrë shtetet drejt një transformimi të sektorit energjetik i cili kontribuon në përmbushjen e kërkesave për energji elektrike duke mos cenuar të drejtat e njeriut dhe duke mos lënë askënd prapa, e në të njëjtën kohë duke kontribuar në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. E që një transformim i tillë të jetë i suksesshëm, duhet të jetë i kordinuar dhe gjithëpërfshirës duke siguruar të ardhme të qëndrueshme dhe të përballueshme.

Një transformim i sektorit të energjisë ofron mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, përfshirje sociale, siguri energjetike, përmirësim të shëndetit, krijim të vendeve të reja të punës dhe përfitime të tjera shoqërore.<sup>7</sup> Të tilla mundësi do të arrihen vetëm nëse transformimi zbatohet në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Megjithëse qeveria duhet të marrë drejtimin në përcaktimin e synimeve dhe procesit, përfshirja e sektori privat, qytetet, shoqëria civile por edhe më gjerë, duke përfshirë rininë, janë thelbësore për hartimin e një procesi të balancuar dhe të drejtë të tranzicionit që është në përputhje me Agjendën 2030 dhe që plotëson akterët ekonomikë dhe prioritetet sociale. Një mundësi e tillë është shfrytëzuar nga shumë shtete të cilat tashmë kanë përfunduar një tranzicion të tillë, ose të cilat janë në fazë të avansuar të tranzicionit. Ndërsa për vendet në zhvillim siç është Kosova, procesi i tranzicionit është më i ngadaltë pasi që faktorët ekonomik dhe politik janë problematikë e madhe e cila shpërfaq vështirësi të konsiderueshme për procesin në tërësi.

Tranzicioni i drejtë energjetikë ka për bazë disa faktorë, të cilët mundësojnë që procesi si i tillë të konsiderohet i përmbushur dhe i suksesshëm. Këta faktorë janë:

- Politika adekuate për të gjithë sektorët e involvuar në tranzicion,
- Veprimet direkte kundrejt ndryshimeve klimatike,
- Parimi “askush të mos lihet mbrapa”,
- Ndihmë shtesë për personat të cilët preken direkt nga tranzicioni i energjisë dhe grupet e cënueshme të konsumatorëve, dhe
- Krijimi i vendeve të reja të punës.

Pa përmbushjen e këtyre pikave, tranzicioni si proces nuk mund të quhet as i përmbushur e as i drejtë.

---

<sup>7</sup> Kombet e Bashkuara, Raporti mbi tranzicionin energjetik, e qasshme në [https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/2021-twg\\_2-062321.pdf](https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/2021-twg_2-062321.pdf), (qasur në maj, 2022)



### **Politika adekuate për të gjithë sektorët e involvuar në tranzicion**

Gjelbërimi i ekonomive në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe çrrënjësjes së varfërisë do të kërkojë një përzierje specifike për një vend të politikave makroekonomike, industriale, sektoriale dhe të punës që krijojnë një mjedis të favorshëm për ndërmarrjet e qëndrueshme që të përparojnë dhe krijojnë mundësi pune të denjë, duke mobilizuar dhe drejtuar publikun dhe investimet private drejt aktiviteteve të qëndrueshme mjedisore. Synimi duhet të jetë krijimi i vendeve të punës në të gjithë zinxhirin e furnizimit, në sektorë dinamikë dhe me vlerë të lartë të shtuar, të cilët stimulojnë përmirësimin e vendeve të punës dhe aftësive, si dhe krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e produktivitetit në industritë më intensive të punës që ofrojnë mundësi punësimi në një shkallë më të gjerë.<sup>8</sup>

### **Veprimet direkte kundrejt ndryshimeve klimatike**

Kalimi nga burimet fosile në burime të ripërtëritshme (BRE) si burime primare të energjisë elektrike është thelbi i një tranzicioni të drejtë energjetik. Kjo për faktin se shumica e ndryshimeve klimatike dhe dëmeve të tjera janë shkaktuar nga emetimi i gazrave serrë, të cilat janë liruara me rastin e djegies së burimeve fosile përgjatë procesit të prodhimit të energjisë elektrike. Stimulimi i BRE-ve dhe shtimi i kapaciteteve të tyre do të krijojë një mjedis më të pastër dhe do të ulë varshmërinë nga burimet që tashmë kanë shkaktuar dëme kolosale. Andaj edhe Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031 parasheh integrimin e mëtutjeshëm të BRE-ve krahas distancimit nga thëngjilli.

### **Parimi “askush të mos lihet mbrapa”**

Tranzicioni energjetik ka kosto dhe prek shtresa të ndryshme të shoqërisë. Duke ditur që Kosova është vend në zhvillim dhe gjendja ekonomike e familjeve kosovare nuk është e kënaqshme, atëherë institucionet dhe akterët kryesues të procesit të tranzicionit duhet të sigurohen që ky proces të mos ndikojë në varfërimin, dëmtimin apo krijimin e efekteve negative tek asnjë familje e shoqëri kosovare. Pra të përfshihen gjithësecili në shtyrjen përpara të transformimit të sektorit energjetik, duke mos shkaktuar dëme për asnjërin.

---

<sup>8</sup> Kombet e Bashkuara, Just Transition of the Workforce, and the Creation of Decent Work and Quality Jobs, e qasshme në <https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Just%20transition.pdf>, (qasur në qershor, 2022)

### **Ndihmë shtesë për personat të cilët preken direkt nga tranzicioni i energjisë dhe grupet e cenueshme të konsumatorëve**

Korporata Energjetik e Kosovës (KEK) dhe punëtorët që janë pjesë e këtij institucioni preken direkt nga tranzicioni. Kjo pasi që tranzicioni i energjisë parashesh dekarbonizimin e plotë, andaj një gjë e tillë nuk mund të arrihet pa mbylljen e termocentraleve. Aktualisht, KEK ka 3628 punëtorë që sigurohen për mbarëvajtjen e procesit të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë.<sup>9</sup> Kjo forcë punëtore dhe grupet e cenueshme të konsumatorëve, pra familjet që kanë vështirësi apo pamundësi përballimi të kostos së shfrytëzimit të energjisë elektrike, duhet të mbështeten dhe të mos penalizohen nga procesi i tranzicionit energjetik. Prosesi si i tillë krijon vende të reja të punës, andaj përmbushja e këtyre vendeve mund të realizohet përmes fuqisë punëtore nga grupet e lartëcekura.

### **Krijimi i vendeve të reja të punës**

Që procesi i tranzicionit të drejtë të përshpejtohet në sektorët më ndotës të Kosovës, ekziston një nevojë e madhe për angazhimin e qeverisë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të zgjeruar. Në një kontekst investimi të karakterizuar nga ndryshime të shpejta teknologjike dhe politike, do të duhet të merren vendime për investime, krijim të vendeve të reja të punës dhe politika në lidhje me rrezikun e bllokimit të aktiveve. Një ndërlidhje e tillë do të ofronte përshpejtim, siguri dhe qëndrueshmëri jo vetëm për personat e punësuar në këtë fushë, por edhe për ekonominë shtetërore dhe sektorin e energjisë në përgjithësi. Duke marrë për bazë procesin e tranzicionit në shtetet e tjera, është vërtetuar se numri i vendeve të reja të punës që krijohen, është shumë i lartë.

Këto praktika duhet të ndiqen në mënyrë që të vlerësohen parimet dhe proceset të cilat bëjnë të mundur arritjen e tranzicionit të drejtë dhe për të përmbushur praktikatat transformuese. Në këtë drejtim duhet të bashkëpunojnë dhe të kordinohen të gjitha institucionet të cilat janë pjesëmarrëse dhe shtytëse të këtij procesi kaq të rëndësishëm jetësor. Si rezultat i këtij kooperimi, do të mund të përmbushej kritika dy dimensionale, pra përfshirja sociale dhe veprimet kundrejt ndryshimeve klimatike.

---

<sup>9</sup> Korporata Energjetike e Kosovës, Publikime, Raportet Vjetore, Raporti Vjetor 2021, e qasshme në <http://kek-energy.com/kek/raportet-vjetore/>, (qasur në qershor, 2021)

Deri më tani, Kosova ka qenë e përfshirë në një numër inicativash në nivel ndërkombëtar, siç është Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor e nënshkruar në nëntor të vitit 2020, ku Kosova u zotua që deri në vitin 2050 të bëhet një vend neutral ndaj klimës për sa i përket energjisë, ekonomisë qarkore, ndotjes, bujqësisë dhe biodiversitetit. Si rezultat, Kosova duhet të fokusohet që të ketë sinergji ndërmjet të gjitha strategjive zhvillimore relevante në Kosovë dhe të zhvillojë një strategji energjetike me një plan të qartë dhe me efekte të stabilitetit të furnizimit dhe qëndrueshmëri të sistemit e tregut energjetik, si dhe të përcaktojë datën kur do të ndalojë përdorimin e thëngjillit meqë është e qartë se kapacitetet e vjetruara të thëngjillit tashmë janë joefikase, të shtrenjta për të i përdorur, dhe i shkaktojnë dëme të mëdha shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit. Atyre iu ka mbaruar jetëgjatësia dhe paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë për stabilitetin energjetik në Kosovë, siç edhe është dëshmuar në krizën e fundit energjetike.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031<sup>10</sup>, ka të integruara elemente të rëndësishme të tranzicionit energjetik. Për më tepër, vizioni i kësaj strategjie përcakton qartë se Kosova duhet të arrijë sa më shpejtë transformimin e sektorit energjetik, në mënyrë që viti 2050 të e pret Kosovën së një shtet neutral ndaj karbonit.

**“Një sektor energjetik pa CO<sub>2</sub> deri në vitin 2050, i integruar në tregun Pan-Evropian, që garanton siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përbalueshmëri për qytetarët.”**

Nisur nga ky vizion afatgjatë, edhe objektivat e strategjisë janë përshtatur dhe janë vendosur në mënyrë të zëvendësimit të burimeve fosile me burime të ripërtëritshme të energjisë, mbrojtje të konsumatorit, besueshmëri për sistemin etj. Pesë objektivat e kësaj strategjie, e cila paraqet bazën politike dhe strategjike të tranzicionit energjetik në Kosovë janë<sup>11</sup>:

1. Pëmirësimi i besueshmërisë së sistemit
2. Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme
3. Rritja e eficiencës së energjisë
4. Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut
5. Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve

Këto objektiva do të jenë udhërrëfyesit e procesit transformues të sektorit elektroenergjetik të Kosovës.

---

<sup>10</sup> Draft Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022, (qasur në qershor, 2022)

<sup>11</sup> Ibid

## Definimi i konceptit dhe shtrimi i problemit

Termi “Just Transition” për Kosovën paraqet rrethana më të vështira dhe problematika shtesë krahasuar me shumë vende që kanë përfunduar ose janë në fazën e tranzicionit. Përpos qështjeve ekonomike, ku dihet se Kosova është shtet relativisht i ri dhe me një ekonomi jo të kënaqshme, Kosova dihet se prodhon shumicën më të madhe të energjisë elektrike përmes thëngjillit. Andaj tranzicioni i drejtë apo “Just Transition” nënkupton për Kosovën largimin nga thëngjilli dhe mbylljen e termoelektranave, taksimin e karbonit, digjitalizimin e transportit dhe minimizimin e emetimeve të karbonit nga sektorët e tjerë ndotës. Mirëpo krahas kësaj, punëtorët të cilët zhvillojnë aktivitetet e tyre në këta sektorë ndotës duhet gjithashtu të akomodohen nëpër vende të reja të punës të cilat lidhen me punën e tyre aktuale. Kjo për faktin që tranzicioni i drejtë nuk nënkupton vetëm transformimin e sektorit energjetik por edhe gjithpërfshirjen sociale dhe mospenalizimin e asnjë individi.

Problematikat kryesore që Kosova do të has në procesin e tranzicionit janë:

- Harmonizimi i politikave të gjelbra me problemet sociale
- Diversifikimi i burimeve dhe krijimi i fleksibilitetit
- Krijimi i vendeve të punës për personat e prekur nga transformimi i sektorit të energjisë
- Sigurimi i fondeve për realizimin e transformimit
- Tërheqja e investitorëve të huaj
- Integrimi në tregun e përbashkët energjetik me shtetet e Ballkanit Perëndimor
- Sigurimi i rezervës sekondare dhe terciare brenda territorit të Kosovës

Është e rëndësishme që zgjidhja për këto problematika të analizohet para se të filloj procesi i tranzicionit, në mënyrë që procesi si i tillë të mos ketë ngecje gjatë fazave implementuese të tij.

## II. Shtyllat kryesore të tranzicionit të drejtë në Kosovë

Kosova është vend i cili bazon prodhimin e energjisë elektrike nga djegia e thëngjillit në termocentrale. Një resurs i tillë, i cili tashmë është edhe më i shtrenjtë se burimet e ripërtëritshme të energjisë, nuk përkrahet nga shumica e shteteve të huaja, e po ashtu nuk përkrahet as nga mekanizmat ndërkombëtarë financiar. Andaj, transformimi dhe kalimi nga burimet e dëmshme të energjisë në burime të cilat nuk emetojnë gazra serrë përpos që është politikë mbarëbotërore dhe detyrim që i imponohet Kosovës nga marrëveshjet e arritura më herët, është edhe përparësi financiare dhe strategjike.

Shtyllat kryesore të tranzicionit të drejtë në Kosovë bazohen në uljen e emetimeve të gazrave serrë, gjithëpërfshirjen dhe mbrojtjen e konsumatorëve dhe grupeve të cenueshme. Një nga mënyrat për të përshpejtuar uljen e ndryshimeve klimatike është të sigurohet se është përfshirëse dhe nuk dëmton askënd.<sup>12</sup> Kjo do të thotë të merret parasysh pasojat e shpërndarjes në mënyrë që asnjëri nuk ka mbetur pas. Është e qartë se përfitimet e tranzicionit do të peshojnë shumë më tepër se kostot që ka pas vetes ky proces. I menaxhuar mirë, tranzicioni do të parandalojë të dyja kostot e mëdha njerëzore dhe ekonomike të prishjes së klimës dhe gjithashtu përmirësimin e kualitetit të jetesës, gjenerimin e shumë vendeve të reja të punës dhe reduktimi i pabarazisë. Në fakt, tranzicioni është thelbësor për të ruajtur punën e denjë e të drejtë si dhe sigurimin e komuniteteve të lulëzuara në dekadat e ardhshme.

Megjithatë, këto përfitime nuk do të ndodhin automatikisht apo vetvetiu. Nevojiten veprime konkrete dhe të menjëhershme për të siguruar që vendet e punës në ekonominë me karbon të ulët të kenë kushte pune të paktën po aq të mira sa ato në sektorët me karbon të lartë. Përfitimet e ekonomisë me karbon të ulët gjithashtu duhet të rrjedhin përtej vendit të punës në komunitetin më të gjerë. Përveç kësaj, ka implikime të rëndësishme kalimtare për sektorët, rajonet dhe vendet kyçe që duhet të menaxhohen. E bërë keq, rezultati mund të jetë jo vetëm dështim i procesit, por edhe "punëtorë të bllokuar" dhe "komunitete të bllokuara".<sup>13</sup> Përvoja e kaluar e deindustrializimit në shumë pjesë të botës thekson rëndësinë e shikimit përtej ndikimeve të drejtpërdrejta të punësimit për të kuptuar ekosistemin më të gjerë të prosperitetit në rajonet e prekura. Dështimi për ta bërë këtë mund të ngadalësojë ose edhe të pengojë përparimin e klimës, duke kontribuar në stagnimin ekonomik dhe paqëndrueshmërinë politike.

Për të përmbushur këtë proces, qëllimi i një tranzicioni të drejtë për punëtorët dhe komunitetet u përfshi si pjesë e Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike.<sup>14</sup> Në thelbin e tij, tranzicioni i drejtë është një kornizë largpamëse, e orientuar nga veprimet, që identifikon mundësitë për investime publike dhe private në zhvillimin ekonomik që është edhe i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Ndiemon në lidhjen e aktiviteteve ndërmjet organizatave ndërkombëtare, qeverive, bizneseve dhe investitorëve, sektorëve të zhvillimit dhe industrisë, e më e rëndësishmja,


---

<sup>12</sup> The London School of Economics, Climate change and the just transition - A guide for investor action, e qasshme në [https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/22101ijtguidanceforinvestors23november1118\\_541095.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/22101ijtguidanceforinvestors23november1118_541095.pdf), (qasur në qershor, 2022)

<sup>13</sup> Climate Justice Alliance, Just Transition Principles, e qasshme në [https://climatejusticealliance.org/wp-content/uploads/2018/06/CJA\\_JustTransition\\_Principles\\_final\\_hi-rez.pdf](https://climatejusticealliance.org/wp-content/uploads/2018/06/CJA_JustTransition_Principles_final_hi-rez.pdf), (qasur në qershor, 2022)

<sup>14</sup> Ibid

punëtorëve dhe komuniteteve që do të ndjejnë efektet e tranzicionit, qofshin të menaxhuara mirë apo keq, në mënyrë më të mprehtë. Më e rëndësishmja, tranzicioni i drejtë është një agjendë globale për ekonominë e industrializuar, si dhe ato në zhvillim siç është Kosova, një agjendë që trajton si dimensionet e dekarbonizimit ashtu edhe ato të kapitujve të tranzicionit.



**Figura 1.** Fushat e veprimit të tranzicionit energjetik


Gjatë procesit të tranzicionit, Kosova duhet të ketë parasysh veprimet e shteteve tjera që kanë përfunduar ose janë në proces të tranzicionit të drejtë. Mësimet e nxjerra nga vendet e tjera do të kontribuojnë që Kosova të mos shkaktojë pasoja për qytetarët e saj, të sigurojë një treg të qëndrueshëm energjetik dhe të arrijë të kalojë nga burimet fosile në burime të ripërtëritshme të energjisë. Tashmë me Strategjinë e Energjisë për 10 vitet e ardhshme, Kosova ka vendosur një kornizë të objektivave të cilat synon të i arrijë, objektiva të cilat janë në linjë me tranzicionin e drejtë energjetik.

Kosova ka nevojë për një proces të tillë, duke ditura gjendjen e sektorit energjetik, aspiratën për integrim në Bashkimin Evropian dhe synimin e dekarbonizimit të vendit deri në vitin 2050. Një arritje e tillë do të kërkojë kohë dhe zhvillime të hovshme, koordinim ndër-institucional dhe investime publike dhe private, në mënyrë të përmirësimit dhe shtimit të kapaciteteve gjeneruese, shtimit të masave të efikasitetit të energjisë dhe arritjes së sigurisë së furnizimit. Prandaj, të kuptuarit e situatës aktuale dhe të ardhshme të zhvillimeve të procesit të tranzicionit të drejtë energjetik në Kosovë janë me rëndësi të madhe si për sektorin publik, ashtu edhe për atë privat.



## Prodhimi i energjisë në Kosovë

Kosova ka kapacitet total operativ të prodhimit të energjisë elektrike në vlerën 1,236 MW.<sup>15</sup> Nga kjo vlerë, 960 MW prodhohen nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B përmes djegies së thëngjillit, ndërsa 276 MW prodhohen nga teknologjitë gjeneruese përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Integrimi i mëtutjeshëm i burimeve të ripërtëritshme, do të rriste kapacitetin prodhues energjetik, e në të njëjtën kohë do të kontribuonte në zhvillimin e një tregu më të suksesshëm.



**Grafiku 2.** Kapaciteti total operativ i prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë, **Burimi:** ZRRE

Termocentralet tashmë të stërvjetëruara, e të cilat nuk kanë mundësi teknike të operimit në kapacitetet e tyre optimale nuk garantojnë siguri as për zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo paraqet një tjetër arsye se pse Kosova e ka të domosdoshëm arritjen e transformimit të sektorit elektroenergetik, në mënyrë të hapjes së mundësive të reja dhe arritjes së objektivave strategjike. Ndër të tjera, kapacitetet prodhuese të Kosovës nuk ofrojnë as siguri energjetike, as qëndrueshmëri, e krahas këtyre elementeve nuk plotësojnë as kërkesat e konsumatorëve.

Siguria energjetike paraqet qasjen në burimet e energjisë elektrike me një qëndrueshmëri të furnizimit dhe çmim të përballueshëm për konsumatorët. Siguria energjetike vie në pah atëherë kur ka më së shumti kërkesë për të dhe ajo paraqet bazën e funksionimit të një tregu të mirë energjetik. Sot me avansimin e teknologjisë nevoja për energji elektrike vetëm sa është rritur dhe konsumatorët kërkesën kryesore e kanë që të furnizohen me energji elektrike gjatë gjithë kohës dhe me çmim të përballueshëm. Integrimi i burimeve të ndryshme për gjenerimin e energjisë

<sup>15</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Publikimet, Raportet Vjetore, Raporti Vjetor 2021, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021\\_ZRRE\\_Shqip.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021_ZRRE_Shqip.pdf), (qasur në qershor, 2022)

elektrike do t'i siguronte Kosovës furnizim me energji elektrike pa ndërprerje për konsumatorët e saj.

Qëndrueshmëria e furnizimit paraqet bazën e sigurisë energjetike. Kjo do të thotë që furnizimi pa reduktime të energjisë elektrike dhe kualiteti i lartë i energjisë duhet të paraqet një standard të secilit vend. Sipas raportit vjetor të ZRRE-së, gjatë vitit 2021 reduktimet e energjisë si pasojë e mungesës së saj kanë qenë 29,068 MWh.<sup>16</sup> Siguria energjetike vetëm sa do të rritet me arritjen e diversifikimit të burimeve prodhuese të energjisë elektrike dhe kjo paraqet një tjetër avantazh të procesit të tranzicionit.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031 synon të rrisë kapacitetet prodhuese vendore. Në objektivin e dytë të kësaj strategjie, si një nga caqet kryesore thuhet:

“Zhvillimi i kapaciteteve të reja të BRE-ve të erës dhe fotovoltaike, **për të arritur një kapacitet të përgjithshëm të instaluar të BRE-ve prej së paku 1400 MW** (përfshirë këtu 100 MW të kapacitetit të konsumatorëve vetë-prodhues) deri në 2031, me mundësi të rritjes së këtij caku nëse një gjë e tillë është e mundshme.”

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira dhe stabilitetit të sektorit, këto numra janë mjaft ambicioz dhe shprehshëm sa i përket transformimit të sektorit. Mirëpo burimet e ripërtëritshme kërkojnë edhe kushte fleksibiliteti sa i përket rezervave energjetike.

Në Kosovë momentalisht sigurohet vetëm rezerva primare prej 5 MW nga ana e termocentraleve, e quajtur rezerva FCR. Rezerva sekondare dhe terciare (aFRR dhe mFRR) sigurohen nga sistemi elektroenergetik i Shqipërisë. Rezerva automatike e rivendosjes së frekuencës (aFRR), e njohur gjithashtu si rezervë sekondare, është një rezervë në rrjetin elektrik që ndihmon në mbajtjen e qëndrueshme të frekuencës së rrjetit. Për të mbajtur frekuencën brenda kufijve të caktuar, Operatorët e Sistemit të Transmetimit aktivizojnë shërbime balancuese si aFRR, të cilat i marrin nga Ofruesit e Shërbimeve Balancuese.<sup>17</sup> Vendet ndryshojnë në specifikimet e tyre, por pas harmonizimit evropian të tregjeve balancuese, Ofruesit e Shërbimeve Balancuese duhet të sigurojnë që të sigurojnë rezervën brenda 5 minutave. Si rezervë sekondare, aFRR zëvendëson FCR gradualisht pas 30 sekondash, mFRR, rezerva terciare, mbështet ose zëvendëson pjesërisht aFRR pas 12.5 minutash.

Të treja këto rezerva janë të rëndësishme ekzistenciale të pavarësisë energjetike dhe furnizimit të rregullt. Pa këto rezerva, balancimi i rrjetit dhe evitimi i devijimeve do të ishin të pamundura, e rrjedhimisht edhe penalizimet nga ana e ENTSO-E nuk do të mungonin. Prandaj, burimet e ripërtëritshme si burime të vështira në aspektin e fleksibilitetit, sigurimi i këtyre rezervave përmes kapaciteteve vendore do të ndihmonte shumë në rregullimin dhe përmirësimin e sektorit në përgjithësi.

---

<sup>16</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Publikimet, Raportet Vjetore, Raporti Vjetor 2021, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021\\_ZRRE\\_Shqip.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021_ZRRE_Shqip.pdf), (qasur në qershor, 2022)

<sup>17</sup> NEXT, What is aFRR (automatic frequency restoration reserve) and how does it work?, e qasshme në <https://www.next-kraftwerke.com/knowledge/afrr>, (qasur në qershor, 2022)

## Rrjeti dhe tregu

Rrjeti i energjisë elektrike të Kosovës ka nevojë për investime dhe përditësim të teknologjisë. Janë dy rrjete kryesore të sektorit të energjisë në Kosovë:

- Rrjeti transmetues
- Rrjeti shpërndarës

Rrjeti transmetues, që operohet nga KOSTT, luan rol të rëndësishëm në sistemin elektroenergetik duke bërë të mundur transmetimin e sasive të mëdha të energjisë elektrike nga gjeneratorët vendor dhe nga importet, deri te konsumatorët e mëdhenj dhe nyjet shpërndarëse. Varësia në rritje për energji elektrike nënkupton që toleranca për ndërprerje të furnizimit duhet të jetë minimale, ndërsa ndërprerjet e tejkujtura nuk mund të pranohen. Kjo në të ardhmen detyrimisht implikon standarde të larta të furnizimit nga rrjeti transmetues. Rrjeti shpërndarës, që operohet nga KEDS, bënë të mundur transmetimin e energjisë elektrike të nivelit nën 110 kV nga nyjet shpërndarëse deri në transformatorë dhe pastaj tek konsumatorët.

Rrjeti transmetues operon në nivele evropiane dhe humbjet që shkaktohen janë të nivelit të pranueshëm. Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm 1.26% ndaj energjisë së futur në transmetim, dhe janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë.<sup>18</sup> Një gjë e tillë nuk vlen edhe për rrjetin e shpërndarjes.

Gjatë vitit 2021, humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes kanë qenë 12.46%, ndërsa konsumi i energjisë i cili nuk ka qenë i autorizuar ka qenë 12.11%.<sup>19</sup> Rrjeti i vjetërsuar, konsumet të cilat nuk faturohen dhe përdorimi ilegal i energjisë elektrike (vjedhja e energjisë elektrike) janë arsyet kryesore që shifrat e humbjeve janë ende të larta në këtë rrjet. Andaj investimet duhet të orientohen në këtë drejtim, duke ditur që këto vlera të larta të humbjeve ndikojnë në destabilizimin e të gjithë sektorit të energjisë.

Edhe pse si shtet është i pavarur që nga viti 2008, në aspektin energjetik Kosova është konsideruar si territor i brendshëm i Serbisë deri në vitin 2020. Deri në këtë vit, Kosova ka hasur në telashe të mëdha në shumë aspekte të sektorit energjetik. Importi dhe rrugët e bllokuara të autostradave energjetike, kostot financiare, mosfunksionimi i linjës interkonektive 400kV me Shqipërinë, kanë qenë disa nga problemet kryesore që ne si vend kemi hasur gjatë kohës sa konsideroheshim pjesë e brendshme e territorit të Serbisë. Me arritjen e pavarësishtit energjetik të Kosovës dhe njohjen e saj si zonë e pavarur energjetike, problemet e cekura më lartë filluan të mos paraqiten.

Me datë 20 prill 2020 u votua nga Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE), Marrëveshja e re për kyçjen mes KOSTT-it dhe ENTSO-E.<sup>20</sup> Deri në prill të vitit 2020, Kosova ka qenë pjesë e Bllokut rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni Veriore). Sipas kësaj marrëveshje, Kosova

---

<sup>18</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Publikimet, Raportet Vjetore, Raporti Vjetor 2021, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021\\_ZRRE\\_Shqip.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202021_ZRRE_Shqip.pdf), (qasur në qershor, 2022)

<sup>19</sup> Ibid

<sup>20</sup> KOSTT, Për media, Përmbillet me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, e qasshme në <https://www.kostt.com/News/New/2021>, (qasur në qershor, 2022)

largohej përfundimisht nga Blloku rregullues SMM, dhe njihej si territor energjetik i pavarur. Kosova i bashkohet tashmë Bllokut rregullues me Shqipërinë, që ndryshe njihet edhe si Blloku AK (Albania-Kosovo). Po ashtu, linja interkonektive 400kV, e cila u ndërtua në vitin 2016 dhe e cila nuk lejohej nga Serbia që të funksionalizohej, tashmë e ka të mundur operimin pa asnjë problem. Kosova dhe Shqipëria si dy zona energjetike të veçanta, e kanë të hapur tashmë rrugën drejt themelimit të tregut të përbashkët elektroenergjetik dhe një gjë e tillë pritet shpejtë të konkretizohet.

Tregu është komponenta kryesore e bashkimit energjetik, proces i cili tashmë ka vendosur hapa të konsiderueshëm në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Tregu paraqet bashkimin e interkonektorëve dhe më pastaj tregtimin e energjisë përmes tyre. Krijimi i një tregu të përbashkët energjetik është i favorshëm për secilin shtet . Kjo pasi që siguron rrjedhje më të sigurtë të energjisë, alokim më të lehtë të kapaciteteve, tregtim më të shpejtë dhe më të lirë, si dhe siguron çmim më të përballueshëm për konsumatorët. Objektivat e ENTSO-E, Strategjitë e Energjisë, Direktivat e Bashkimit Europian dhe Pakoja e Tretë e Energjisë e përkrahin integrimin e tregjeve në një të vetëm, duke konstatuar se kjo garanton më shumë transparencë dhe likuiditet më të madh si për tregtarët dhe operatorët, ashtu edhe për blerësit. Kosova dhe Shqipëria në të ardhmen e afërt synojnë një treg të përbashkët jo vetëm me njëra tjetrën, por edhe me vendet tjera të Ballkanit, e pse jo edhe me vendet e tjera të Evropës më pastaj.

Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe parimet që mbanë në vete shtyjnë zonat energjetike të bashkohen me njëra tjetrën dhe të krijojnë tregje të përbashkëta të energjisë. Disa nga favorret e shteteve në tregje të përbashkëta energjetike janë:<sup>21</sup>

- Tregu i përbashkët energjetik do të krijonte mundësi më të mëdha investuese
- Tregu i cili përmban në vete numër më të madh të konsumatorëve, është më tërheqës edhe për investitorin, pasi që paraqet më shumë siguri për investim nga ana e tij
- Konsumatori përfiton nga përdorimi i burimeve të ripërtrishme të energjisë, sepse çmimi i tyre është më i lirë në një treg më të madh
- Tregu i përbashkët energjetik krijon mundësi në avansimin e përdorimit më të madh të burimeve të ripërtëritshme


Këto dhe shumë benefite të tjera, siç është operimi më i lehtë i sistemit janë arsye dhe bazë mbi të cilën Qeveria e Kosovës duhet të konkretizojë bashkimin energjetik me Shqipërinë, e më pastaj edhe zgjerimi i tregut të përbashkët me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

---

<sup>21</sup> INDEP, Bashkimi Energjetik Kosovë-Shqipëri - Sfidat dhe Mundësitë për të Ardhmen, e qasshme në [https://indep.info/wp-content/uploads/2021/11/INDEP\\_Bashkimi-energjetik-Kosove-Shqiperi.pdf](https://indep.info/wp-content/uploads/2021/11/INDEP_Bashkimi-energjetik-Kosove-Shqiperi.pdf), (qasur në qershor, 2022)

## Konsumi i energjisë në Kosovë

Urbanizimi, zhvillimi teknologjik dhe shtimi i popullësisë janë arsyet kryesore të rritjes së konsumit të energjisë në Kosovë. Norma mesatare vjetore e rritjes së konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike për gjatë 10 viteve të fundit në Kosovë ishte 1.4%, e nxitur kryesisht nga rritja në sektorin e amvisërisë.<sup>22</sup> Gjersa rritja e kërkesës vazhdon secilin vit me rradhë, shtimi i kapaciteteve operative gjeneruese nuk është shtuar në linjë të njëjtë sa që të përballojë kërkesën e përgjithshme.



**Grafiku 3.** Kërkesa për energji elektrike nga viti 2010-2020 në Kosovë, **Burimi:** Draft Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031

Në Kosovë kërkesa dhe konsumi më i madh i energjisë shfaqen gjatë muajve të ftohtë të vitit. Kjo për arsye se elementin e ngrohjes, familjet kosovare e arrijnë përmes shfrytëzimit të energjisë elektrike, si forma më e përshtatshme dhe aktualisht më e lirë e ngrohjes. Shfrytëzimi i tillë i energjisë elektrike ndikon negativisht në ambient, e gjithashtu nuk stimulon familjet në shtimin e masave të efijencës së energjisë.

Kosova përballet edhe me elementin e shfrytëzimit të energjisë elektrike e cila është e paautorizuar. Faktori kryesor në shpërfaqjen e kësaj dukurie negative vazhdojnë të jenë katër komunat veriore të Kosovës, të cilat nuk faturohen e rrjedhimisht edhe kryejnë obligimin e pagesës ndaj furnizuesit të tyre. Sipas Raportit Vjetor 2021 të Zyrës së Rregullatorit për Energji, vlera e energjisë së paautorizuar të shfrytëzuar nga këto komuna është 5.95% apo 372 GWh. Një problematikë e tillë ndikon në destabilizimin e të gjithë sektorit energjetik, pasi që ajo energji elektrike nuk mund të mbetet e pafaturuar e as nuk mund të mbetet e papaguar. Andaj tash e sa kohë, KOSTT është i obliguar që të mbulojë koston e energjisë elektrike të konsumuar nga këto komuna.

<sup>22</sup> Draft Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022, (qasur në qershor, 2022)

### III. Rasti i studimit të Suedisë drejt tranzicionit të drejtë energjetik

Gjatë viteve të 70-ta, Suedia gjeneronte energji elektrike nga burimet fosile kryesisht. Mirëpo duke qenë vend që varej nga importi i këtyre burimeve, Suedia nuk kishte siguri të furnizimit dhe as qëndrueshmëri të sistemit energjetik. Rreziku për sigurinë e furnizimeve që sillte një varësi e tillë e jashtme u perceptua më pas, dhe përgjigja e politikës ishte përdorimi i energjisë bërthamore. Kjo aspiratë u forcua nga goditja globale e naftës në vitin 1973. Në vitin 1986, energjia bërthamore ishte bërë burimi i parë i energjisë në bilancin primar të Suedisë.<sup>23</sup> Ndërmjet viteve 1970 dhe 1990, pjesa e produkteve të naftës në bilancin përfundimtar të energjisë pothuajse u përgjysmua, ndërsa konsumi i energjisë elektrike u dyfishua. Një gjë e tillë shkaktoi probleme të theksuara për Suedinë, siç ishin deficitet buxhetore, shtimi i papunësisë, rrezikimi i mëtutjeshëm i furnizimit me energji elektrike, zhvillim ekonomik i ngadalshëm e kështu me rradhë. Andaj, reforma të theksuara nevojiteshin për Suedinë.

Reformat kryesore orientoheshin në sektorin e energjisë. Këto reforma përfshinin politika të gjelbra, të cilat tentonin përmirësimin e sektorit, e të cilat janë:

- U zbatua një politikë liberalizimi për sektorët e gazit dhe energjisë elektrike
- Riparimi i sistemit të taksave u shtri në taksimin e energjisë, me vendosjen e një takse për emetimet e CO<sub>2</sub>
- Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme dhe shtimi i masave të eficientës së energjisë
- Dëshira për të ruajtur furnizimet me energji me një kosto të moderuar për industrinë çoi në funksionimin e vazhdueshëm të termocentraleve bërthamore të Suedisë dhe jo në mbylljen e tyre të hershme

Këto politika të Suedisë ishin udhërrëfyes në distancimin gradual nga burimet fosile dhe në gjelbërimin e sektorit.

Në vitin 2017, Parlamenti suedez miratoi një kornizë të politikës klimatike që përshkruan qasjen e Suedisë për respektimin e Marrëveshjes së Parisit.<sup>24</sup> Korniza vendos objektiva ambicioze për klimën dhe energjinë dhe shkon më tej se fokuset e Bashkimit Evropian për neutralitetin klimatik të vitit 2050 dhe objektivat aktuale të energjisë dhe klimës për vitin 2030. Suedia është zotuar të zvogëlojë të gjitha emetimet neto të gazrave serrë në atmosferë në zero deri në vitin 2045 dhe duke përdorur 100 për qind energji të rinovueshme në vitin 2040. Korniza e Politikave Klimatike përfshin gjithashtu një akt për klimën, i cili rregullon punën e politikës klimatike të qeverisë, duke përfshirë synimet e saj të përgjithshme dhe mënyrën se si ato duhet të zbatohen. Këto politika të

---

<sup>23</sup> Ibid

<sup>24</sup> Sweden's Climate Act and Climate Policy Framework, e qasshme në <https://www.naturvardsverket.se/en/topics/climate-transition/sveriges-klimatarbete/swedens-climate-act-and-climate-policy-framework/#:~:text=In%202017%20Sweden%20adopted%20a,by%202045%20at%20the%20latest,> (qasur në qershor, 2022)



përdorura nga shteti suedez tregojnë vendosshmëri dhe synim të qartë që deri në vitin 2045, ky shtet të arrijë një tranzicion të drejtë energjetik.

Suedia krahas shteteve tjera nordike, ka treguar pozicion të qartë karshi politikave që kontribuojnë drejt një tranzicioni të drejtë energjetik edhe më herët, me krijimin e tregut nordik të energjisë. Tregu nordik i energjisë elektrike është një treg i përbashkët për vendet skandinave i cili si burim kryesor të gjenerimit i ka burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe që përdor mënyra të avansuara të tregtimit të saj. Norvegjia, Suedia, Finlanda dhe Danimarka kanë ndarë prej kohësh një treg të vetëm të energjisë elektrike dhe shërbejnë si një shembull kryesor për vendet e tjera në mbarë botën se si të liberalizojnë tregjet e energjisë elektrike përtej kufijve kombëtarë. Interkonektorët bashkohen mes vete në vendet tokësore dhe ujore, dhe formojnë një treg të përbashkët i cili siguron tregti efikase. Duke shfrytëzuar gjenerim të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, tregu nordik ka fituar epitelin e një tregu shembull për vendet e tjera.

Raporti i “World Forum” në lidhje me efektivitetin e tranzicionit të energjisë konfirmon që Suedia mban primatin sa i përket këtij procesi kaq të rëndësishëm.<sup>25</sup> Pikët e indeksit matës për Suedinë në vitin 2021 kanë qenë 79, duke lënë pas shtete si Norvegjia, Danimarka, Zvicrra, Austria e kështu me rradhë. Performanca e sistemit energjetik është vlerësuar me 84.4 pikë, ndërsa procesi i tranzicionit me gjithsej 72.7 pikë. Edhe pse rruga e tranzicionit energjetik të secilit vend është e ndryshme, ata të gjithë ndajnëtribute të përbashkëta duke përfshirë:

- Nivele të ulëta të subvencioneve për lëndët djegëse fosile
- Siguri të përmirësuar të energjisë nga një shumëllojshmëri e përzjerjes së karburanteve dhe importit
- Përmirësimi i intensitetit të karbonit
- Ulje e varësisë nga lëndët djegëse fosile në diversifikimin e energjisë
- Një mjedis të fortë rregullator për të nxitur tranzicionin e energjisë

Hydroenergjinë sot është burimi kryesor i energjisë së rinovueshme në Suedi. Ajo zë shumicën e prodhimeve të energjisë elektrike me 61,605 GWh në 2018, ndërsa energjia e erës është burimi i dytë efikas i energjisë së rinovueshme me më shumë se 20 TWh në 2019.<sup>26</sup> Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme deklaroi se "Sistemi energjetik i vendit është pothuajse tërësisht i dekarbonizuar tashmë, bazuar në burime të gjera hidroenergjetike dhe energji bërthamore, si dhe në ngrohjen qendrore të gjeneruar nga biomasa".<sup>27</sup> Suedia ka integruar me sukses fuqitë e energjisë me objektivat e saj aktuale klimatike, krahas politikave që detyrojnë ndikimet negative në mjedis.

---

<sup>25</sup> World Economic Forum, Fostering Effective Energy Transition 2021, e qasshme në [https://www3.weforum.org/docs/WEF\\_Fostering\\_Effective\\_Energy\\_Transition\\_2021.pdf](https://www3.weforum.org/docs/WEF_Fostering_Effective_Energy_Transition_2021.pdf), (qasur në qershor, 2022)

<sup>26</sup> The Borgen Project, 100% RENEWABLE ENERGY IN SWEDEN BY 2040, e qasshme në <https://borgenproject.org/renewable-energy-in-sweden/>, (qasur në qershor, 2022)

<sup>27</sup> IRENA, INNOVATIVE SOLUTIONS FOR 100% RENEWABLE POWER IN SWEDEN, e qasshme në [https://irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2020/Jan/IRENA\\_Innovative\\_power\\_Sweden\\_2020\\_summary.pdf?la=en&hash=9FC47DCAD97F5001B07663FD7D246872DBC0F868](https://irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2020/Jan/IRENA_Innovative_power_Sweden_2020_summary.pdf?la=en&hash=9FC47DCAD97F5001B07663FD7D246872DBC0F868), (qasur në qershor, 2022)

Çmimi i karbonit është politikë e përdorur së pari në botë nga Suedia. Ndërsa sot Suedia ka çmimin e karbonit më të lartë krahasur me shtetet tjera, duke treguar qartë që burimet e ripërtëritshme të energjisë janë të favorizuara krahas burimeve që tashmë kanë shkaktuar shumë probleme. Gjithashtu hartimi i politikave tjera ka ndikuar në arritjen e shumë objektivave sa i përket transformimit të sektorit të energjisë, duke e bërë kështu shtetit suedez si shembull për shtetet tjera të cilat kanë vendosur të arrijnë një të ardhme të gjelbër e të qëndrueshme.

Suedia ka ndërmarrë hapa drejt tranzicionit energjetik shumë vite më parë. Disa nga politikat kryesore të cilat sot e kanë bërë këtë shtet lider në sektorin energjetik janë<sup>28</sup>:

- Vendi nuk ka rezerva fosile, importon vëllime në rritje të produkteve të naftës qysh në vitet pas Luftës së Dytë Botërore
- Deri në vitet 2000, hidrocentralet mund të hynin në treg pa ndihmën e publikut
- Suedia fillimisht forcoi politikën e saj të efikasitetit të energjisë, duke strukturuar veprimet në terren nëpërmjet një agjencie kombëtare të mbështetur nga organizata partnere në komunitetet lokale për të ndihmuar konsumatorët teknikisht dhe ekonomikisht. Suedia më pas miratoi një instrument të pazakontë për të promovuar energjinë elektrike të rinovueshme, përkatësisht sistemin e saj të certifikatave të gjelbra. I zbatuar në vitin 2003, ky sistem ka nxitur zhvillimin e burimeve më të lira të energjisë së rinovueshme, ku dy të tretat vijnë nga era dhe një e treta nga biomasa.
- Suedia vendosi taksimin ndaj karbonit, si masë stimuluese për burimet miqësore me ambientin
- Integroji tregun energjetik së bashku me vendet e tjera nordike
- Suedia hartoi politika të cilat shtynin sektorin e transportit drejt elektrifikimit, duke zvogëluar kështu emetimet e gazrave serrë që shkaktohen nga ky sektor

---

<sup>28</sup> Études de l'Ifri, The Energy Transition in Sweden, e qasshme në [https://www.ifri.org/sites/default/files/atoms/files/etude\\_suede\\_gd\\_ok-db2\\_complet.pdf](https://www.ifri.org/sites/default/files/atoms/files/etude_suede_gd_ok-db2_complet.pdf), (qasur në qershor, 2022)

**Tabela 1.** Mësimet e nxjerra nga procesi i tranzicionit të drejtë të energjisë së Suedisë, **Burimi:** INDEP

Rasti i Suedisë		
Mësimet e nxjerra nga rasti i Suedisë	Përparësitë në kontekstin e Kosovës	Mangësitë në kontekstin e Kosovës
Suedia fillimisht forcoi politikën e saj të efikasitetit të energjisë, duke strukturuar veprimet në terren nëpërmjet një agjencie kombëtare të mbështetur nga organizata partnere në komunitetet lokale për të ndihmuar konsumatorët teknikisht dhe ekonomikisht	Ulet niveli i konsumit të energjisë së tepërt dhe në të njëjtën kohë ulet barra ekonomike e familjeve e gjithashtu niveli i emetimeve të gazrave serrë	-
Suedia filloi taksimin ndaj emetimeve të karbonit	Zvogëlohet niveli i emetimeve të karbonit	Preken direkt KEK dhe konsumatorët
Suedia integroi tregun e saj energjetik me vendet e tjera nordike	Bashkimi energjetik me Shqipërinë së pari, e më pastaj edhe me shtetet tjera në rajon garanton siguri të furnizimit, përmirësim të rrjetit, rrit mundësitë për liberalizim të tregut dhe ofron kushte më të favorshme për investitorët e huaj	-
Suedia hartoi politika të cilat shtynin sektorin e transportit drejt elektrifikimit	Zvogëlohet niveli i emetimeve të karbonit	Niveli i stacioneve elektrike është i mangët, ndërsa subvencionimi për makina elektrike nuk ekziston
Suedia zvogëloi varësinë ndaj burimeve fosile	Shtyhen përpara teknologjitë prodhuese me BRE	-
Suedia liberalizoi tregun energjetik duke ofruar më shumë hapësirë për të gjithë akterët e sektorit, e gjithashtu edhe për konsumatorët	Rritet konkurrenca, duke ofruar kushte më të favorshme për konsumatorët dhe sektorin në përgjithësi	Marrëveshja për Furnizim me Shumicë <sup>29</sup> është pengesa kryesore e Kosovës drejt liberalizimit të tregut, duke e ditur se kjo marrëveshje detyron KEK-un të furnizojë KEDS-in me të gjithë sasinë e energjisë elektrike të kërkuar

<sup>29</sup> Qeveria e Kosovës, Privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës, Marrëveshja për Furnizim me Shumicë, e qasshme në [https://me.rks-gov.net/repository/docs/MARREVESHJE\\_PER\\_FURNIZIM\\_ME\\_SHUMICE - tetor2012\\_KKDFE.pdf](https://me.rks-gov.net/repository/docs/MARREVESHJE_PER_FURNIZIM_ME_SHUMICE_-_tetor2012_KKDFE.pdf), (qasur në qershor, 2022)

## IV. Implikimet financiare të tranzicionit të drejtë energjetik

Përshpejtimi i tranzicionit të energjisë së pastër në ekonomitë në zhvillim siç është Kosova nuk mund të jetë më vetëm një opsion investimi mes shumë opsioneve të tjera. Ai duhet të bëhet një prioritet kryesor për qeveritë dhe investitorët në mbarë botën. Kjo për faktin që procesi në tërësi nuk paraqet benefite vetëm për Kosovën, por për rajonin dhe globin në përgjithësi duke ditur se në ndryshimet klimatike që dora e njeriut ka shkaktuar, kemi dorë të gjithë andaj edhe përmirësimi i situatës është në dorën e gjithësecilit prej nesh.

Në proceset e tranzicionit të energjisë së pastër, kapitali ka më shumë rëndësi se çdo gjë tjetër. Mundësia për të marrë hua nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe për të shfrytëzuar një pjesë të madhe të borxhit, si dhe për të siguruar kthime adekuate të investimit të rregulluara sipas rrezikut për mbajtësit e kapitalit janë kritike për tërheqjen e investimeve dhe zhvendosjen e alokimeve të kapitalit drejt energjisë së pastër.<sup>30</sup> Menaxhimi i kostove të financimit dhe diversifikimi i burimeve të financimit bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për t'i bërë këto tranzicione të përballueshme. Ndërsa komponenti i borxhit përcaktohet në termat e huave dhe obligimeve bazuar në normat mbizotëruese të interesit, kthimet e kapitalit dhe varen shumë më tepër nga përfitimi i aktiviteteve pas kthimit të borxhit, si dhe nga rreziqet që lidhen me zhvillimin e projektit dhe ndërtimit.

Në Kosovë, procesi i tranzicionit energjetik nënkupton transformimin e sektorit, nga sektori më ndotës në sektorin me më pak emetime të gazrave serrë. Në fakt transformimi i sektorit të energjisë dhe rritja e përdorimit efikas të energjisë elektrike të pastër janë shtyllat kryesore edhe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përbëjnë pjesën më të madhe të reduktimit të emetimeve të nevojshme për të përmbushur qëllimet globale të ndryshimeve klimatike. Duke qenë se një gjë e tillë paraqet një shtyllë kaq të rëndësishme edhe implikimet financiare janë me kosto më të larta.


Investimet në teknologji të prodhimit që shfrytëzojnë burimet e ripërtëritshme, eficienta e energjisë, veturat elektrike, digjitalizimi, krijimi i vendeve të reja të punës dhe shumë elemente të tjera të tranzicionit të drejtë energjetik paraqesin qasje intensive ndaj teknologjisë dhe metodologjisë së uljes së emetimeve duke mos ndikuar në aspektin social të askujt. Ndërsa shpenzimet zhvendosen drejt këtyre teknologjive më intensive, roli i financimit bëhet më kritik për realizueshmërinë dhe përballueshmërinë e tranzicionit të drejtë. Mobilizimi i niveleve shumë më të larta të investimeve do të varet nga politikat dhe kushtet e tregut, si dhe nga synimet e qëndrueshmërisë të përcaktuara gjithnjë e më shumë nga zhvilluesit dhe investitorët, të cilat të gjitha ndikojnë në përfitimin e investimeve.

---

<sup>30</sup> IEA, Financing Clean Energy Transitions in Emerging and Developing Economies, e qasshme në [https://iea.blob.core.windows.net/assets/6756ccd2-0772-4ffd-85e4-b73428ff9c72/FinancingCleanEnergyTransitionsinEMDEs\\_WorldEnergyInvestment2021SpecialReport.pdf](https://iea.blob.core.windows.net/assets/6756ccd2-0772-4ffd-85e4-b73428ff9c72/FinancingCleanEnergyTransitionsinEMDEs_WorldEnergyInvestment2021SpecialReport.pdf), (qasur në qershor, 2022)

Mobilizimi i niveleve shumë më të larta të investimeve në panele solare dhe parqe me erë në shkallë të shërbimeve varet nga politikat e energjisë dhe kushtet e tregut, si dhe nga objektivat e qëndrueshmërisë të përcaktuara gjithnjë e më shumë nga zhvilluesit dhe investitorët, të cilat të gjitha ndikojnë në përfitimin e investimeve. Vendimet e investimit apo jo nga ana e investitorëve të huaj kanë të ngjarë të ndikohen nga<sup>31</sup>:

- Kostot e paneleve solare dhe teknologjisë së erës, të cilat varen nga cilësia e burimeve lokale, tendencat globale të industrisë dhe rrjedha e zinxhirëve të furnizimit në një vend ose rajon të caktuar
- Strategjitë dhe politikat e qeverisë për energjinë e pastër, duke përfshirë dukshmërinë e qartë mbi planet e prokurimit dhe infrastrukturën e projekteve për të krijuar hapësirë për investime
- Pritjet për marrjen e normës së kërkuar të kthimit dhe shërbimin me sukses të borxhit
- Kontrata të mirë-projektuara për të ofruar qartësi mbi të ardhurat dhe për të garantuar aftësinë bankare të projektit
- Kostoja dhe disponueshmëria e kapitalit, e cila varet nga faktorët e mësipërm, si dhe mekanizmat financiarë që trajtojnë çështje specifike si rreziqet e pagesës
- Disponueshmëria dhe kostoja e tokës dhe niveli i infrastrukturës mundësuese të transmetimit për të siguruar një integrim efektiv të burimeve të rinovueshme të ndryshueshme.



<sup>31</sup> IEA, Financing Clean Energy Transitions in Emerging and Developing Economies, e qasshme në [https://iea.blob.core.windows.net/assets/6756ccd2-0772-4ffd-85e4-b73428ff9c72/FinancingCleanEnergyTransitionsinEMDEs\\_WorldEnergyInvestment2021SpecialReport.pdf](https://iea.blob.core.windows.net/assets/6756ccd2-0772-4ffd-85e4-b73428ff9c72/FinancingCleanEnergyTransitionsinEMDEs_WorldEnergyInvestment2021SpecialReport.pdf), (qasur në qershor, 2022)

## Mekanizmat fiskal dhe ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të financimit

Fondet e qëndrueshme ndryshojnë nga fondet konvencionale sepse ato kanë një objektiv të qëndrueshmërisë duke kërkuar gjithashtu kthime financiare. Brenda kësaj klase të gjerë fondesh, disa fonde janë të përqendruara më ngushtë në mjedis dhe një nënkategori tjetër ka të bëjë veçanërisht me zbutjen e ndryshimeve klimatike. Investimet për gjatë procesit të tranzicionit kërkojnë krijimin e një sistemi i cili do të jetë funksional dhe kontribues edhe më vonë, mekanizëm ky i cili shërben vetëm në drejtim të përmirësimit të gjendjes mjedisore, uljen e gazrave serrë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Qeveria e Kosovës së pari, duhet të forcojë sistemin e informacionit klimatik, e cila përfshin të dhëna, zbulime dhe klasifikime të qëndrueshme financiare, si për firmat ashtu edhe për fondet e investimeve. Për shembull, sistemet më të mira të klasifikimit për fondet, ku etiketat dhe taksonomitë e fondeve përdoren dhe kuptohen në mënyrë uniforme, ndihmojnë për të përmbledhur strategjinë e investimit të një fondi dhe qasjen e tij të përgjithshme ndaj angazhimit dhe administrimit. Së dyti, duhet të ekzistojë mbikëqyrja e duhur rregullatore për të parandaluar "projektet e gjelbra", domethënë, për të siguruar që etiketat të përfaqësojnë drejt objektivat e investimit të fondeve. Kjo, nga ana tjetër, rrit besimin e tregut dhe rrit më tej flukset në fonde të qëndrueshme. Së treti, pasi të jenë vendosur këto elemente, mjetet për të kanalizuar kursimet drejt fondeve që përmirësojnë tranzicionin bëhen të rëndësishme. Për shembull, përshtatshmëria e shtuar e fondeve me temën e klimës për trajtim të favorshëm tatimor në produktet e kursimeve mund të ndihmojë në plotësimin e masave të tjera zbutëse të ndryshimeve klimatike, të tilla si taksa e karbonit.

Krijimi i një eko fondi nga ana e Qeverisë së Kosovës do të paraqiste mekanizëm financiar të rëndësishëm sa i përket financimit të tranzicionit, duke synuar që ky mekanizëm të ofrojë qëndrueshmëri afatgjate. Eko Fondi mund të funksionojë i vetëm ose të inkorporojë Fondin aktual të Eficiencës si pjesë e një procesi bashkimi që duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe transformues. Fondet e mbledhura nga taksa e karbonit duhet t'i kthehen komunitetit, por me investime që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të jetesës, rritjen e komoditetit dhe procese të tjera që mbrojnë mjedisin.<sup>32</sup> Investimet në burimet e ripërtrishme, rritja e masave për eficiencën e energjisë dhe përsheptimi i tranzicionit të energjisë janë disa nga kategoritë në të cilat Eko Fondi duhet të ndajë shumën e parave të mbledhura nga taksa e karbonit. Është shumë e rëndësishme që fondet e mbledhura nga taksa e karbonit të shkojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mjedisit dhe jo në investime të tjera që nuk kanë të bëjnë me uljen e emetimeve të karbonit.

---

<sup>32</sup> INDEP, Politikat e taksimit të karbonit – Rëndësia, sfidat dhe mundësitë për Kosovën, e qasshme në <https://indep.info/politikat-e-taksimit-te-karbonit-rendesia-sfidat-dhe-mundesite-per-kosoven/>, (qasur në qershor, 2022)



## Instrumentet e BE-së (IPA III, Fondi i Gjelbër i Klimës dhe Fondi për Tranzicionin e Drejtë)

Bashkimi Evropian përdor instrumente siç është IPA III për të arritur objektivat e Agjendës së Gjelbër. Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit III (IPA III) është fond prej 14.2 miliardë euro i cili do të shërben për të ofruar ndihmë ndaj shteteve të cilat ndërmarrin reforma kryesore politike, institucionale, sociale dhe ekonomike.<sup>33</sup> Ky fond do të trajtojë rimëkëmbjen e qëndrueshme ekonomike, furnizimin me energji, transportin, mjedisin dhe ndryshimet klimatike si dhe transformimin dixhital.

Fondi i Gjelbër i Klimës është një fond i krijuar në kuadrin e UNFCCC si një ent operativ i Mekanizmit Financiar për të ndihmuar vendet në zhvillim në përshtatjen dhe praktikën zbutëse për të luftuar ndryshimet klimatike.<sup>34</sup> Vetëm gjatë vitit 2021, bordi i këtij fondi ka aprovuar afër 3 miliardë euro investime të reja në projekte lidhur me ndryshimet klimatike dhe përmirësimin e ndikimeve negative të shkaktuara nga ky fenomen.<sup>35</sup> Edhe Kosova si shtet në zhvillim e sipër ka mundësi aplikimi në fonde të tilla, duke zvogëluar ndikimin e gazrave serrë që emeton në kuadër të sektorëve të energjisë, transportit, industrisë e amvisërisë.

Fondi për Tranzicionin e Drejtë është instrument financiar për mbështetjen e projekteve në kuadër të procesit të tranzicionit të drejtë. Fondi i Tranzicionit të Drejtë është një instrument i ri financiar në kuadër të Politikës së Kohezionit, i cili synon të ofrojë mbështetje për vendet që përballen me sfida serioze socio-ekonomike që synojnë tranzicionin drejt neutralitetit klimatik.<sup>36</sup> Fondi i Tranzicionit të Drejtë do të lehtësojë zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane<sup>37</sup>, e cila synon ta bëjë BE-në neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050.

Fondi i Tranzicionit të Drejtë zbatohet sipas rregullave të përbashkëta të menaxhimit, që nënkupton bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale. Për të aksesuar mbështetjen e Fondit të Drejtë Tranzicionit, shtetet anëtare (Kosova nuk është shtet anëtar) duhet të paraqesin plane territoriale të tranzicionit të drejtë. Këto plane përshkruajnë fushat specifike të ndërhyrjes, bazuar në ndikimet ekonomike dhe sociale të tranzicionit. Në veçanti, këto plane duhet të marrin parasysh humbjet e pritshme të vendeve të punës dhe transformimin e proceseve të prodhimit të objekteve industriale me intensitetin më të lartë të gazit serrë.

---

<sup>33</sup> Komisioni Evropian, Enlargement region: European Commission welcomes final adoption of EU's new €14 billion pre-accession assistance budget for 2021-2027, e qasshme në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/news/enlargement-region-european-commission-welcomes-final-adoption-eus-new-eu14-billion-pre-accession-2021-09-15\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/news/enlargement-region-european-commission-welcomes-final-adoption-eus-new-eu14-billion-pre-accession-2021-09-15_en), (qasur në qershor, 2022)

<sup>34</sup> Green Climate Fund, e qasshme në <https://www.greenclimate.fund/>, (qasur në qershor, 2022)

<sup>35</sup> Green Climate Fund, Annual Results Report 2021, e qasshme në <https://www.greenclimate.fund/sites/default/files/document/20220412-arr2021.pdf>, (qasur në qershor, 2022)

<sup>36</sup> European Parliament, Just Transition Fund, e qasshme në <https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/214/just-transition-fund#:~:text=The%20Just%20Transition%20Fund%20is%20one%20of%20the%20European%20Union's,growth%20policy%20for%20the%20EU.>, (qasur në qershor, 2022)

<sup>37</sup> EUR-Lex, European Green Deal, e qasshme në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM%3A2019%3A640%3AFIN>, (qasur në qershor, 2022)

Iniciativat e Kosovës dhe palëve tjera nënshkruese të Deklaratës së Sofjes, nga Ballkani Perëndimor do të mbështeten nga Plani Ekonomik i Investimeve për Ballkanin Perëndimor nga Komisioni Evropian me një shumë mbështetëse deri në 9 miliardë euro.<sup>38</sup> Këto fonde nuk janë të ndara apo të destinuara, andaj aplikimi përmes projekteve të gjelbra dhe premtuese do të mund të bëhet për gjithë shumën e ndarë. Andaj mekanizmat financiar për financim të tranzicionit të drejtë ekzistojnë dhe dita ditës ndihma e tyre ndaj shteteve që ndërmarrin këtë proces po shtohet.

---

<sup>38</sup> European Commission, Economic&Investment Plan – European Union, e qasshme në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2022-02/EIP-WB-GG-2022.pdf>, (qasur në qershor, 2022)

## Përfundime

Kosova dhe tregu energjetik gjenden në fazë kritike dhe mjaft të vështirë. Teknologjia e shekujve të kaluar, burime ndotëse dhe rrjet jo stabil e pamundësojnë sigurinë e furnizimit dhe stabilitetin e gjithë sektorit energjetik në Kosovë. Andaj procesi i tranzicionit energjetik duhet të jetë i rëndësishëm më të lartë, në mënyrë që Kosova të arrijë synimet, objektivat dhe premtimet që në vitin 2050 të jetë një shtet neutral ndaj karbonit. Deklarata e Sofjes por tashmë edhe Strategjia e Energjisë për vitet 2022-2031 do të duhet të orientojnë vendin drejt politikave të qëndrueshme e të gjelbra, politika të cilat deri më tani janë të mangëta dhe nuk përbëjnë prioritet aq sa është e nevojshme për këtë proces thelbësor për njerëzimin.

Kosova nuk ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt integritimit të burimeve të ripërtëritshme. Investimet publike janë thuajse zero në këtë drejtim, mirëpo edhe politikat për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe bërjen e tregut më atraktive për ta janë të cekëta dhe nuk përkojnë me kërkesat e investitorëve të jashtëm. Aktualisht Kosova nuk ofron skema mbështetëse për këto burime të energjisë dhe tregu jo i liberalizuar i energjisë e bënë vendin tonë jo të favorshëm krahas tregjeve tjera energjetike në rajon. Mangësi të tilla ndikojnë në mbajtjen lartë të përqindjes së prodhimit të energjisë nga burimet fosile, duke mos pasur alternativa tjera prodhuese nga teknologjitë prodhuese me burime miqësore dhe jo emetuese.

Harmonizimi i politikave dhe hartimi i strategjive për tranzicionin lënë shumë për të dëshiruar, duke ditur që një gjë e tillë nuk është arritur në Kosovë. Politikat e përshtatshme dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën e bëjnë procesin e tranzicionit energjetik më të qartë dhe më të lehtë për tu arritur. Ndërsa hartimi i strategjive të cilat ofrojnë transformim të sektorit energjetik e në të njëjtën kohë krijojnë vende të reja të punës dhe trajtojnë ndikimet sociale që ky proces do të ketë, janë në faza të hershme dhe jo të kënaqshme. Duke ditur që tranzicioni i drejtë energjetik synon jo vetëm transformim por edhe gjithpërfshirjen dhe mos ndikimin në ekonomitë familjare, shteti ynë nuk ka bërë thuajse asgjë drejt hartimit të strategjive dhe planeve operative të cilat detajizojnë procesin dhe ofrojnë zgjidhje në të mirë të secilit qytetar të Kosovës.

Konsumi i energjisë mbetet ende i lartë dhe vit pas viti vetëm sa po rritet, duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike dhe shtimin e popullësisë. Konsumi i tepërt dhe i panevojshëm është në shkallë të lartë në Kosovë. Një fenomen i tillë rrjedh si pasojë e mungesës së masave të eficientës së energjisë dhe mos zbatimit të standardeve të ndëritimit.

Suedia është shembulli më i mirë në procesin e tranzicionit energjetik. Harmonizimi i politikave, strategjitë afatgjate dhe të qëndrueshme, ku në qendër të tyre ishte siguria e furnizimit dhe integritimi i tregut duke shfrytëzuar BRE-të janë vetëm disa nga pikat përmes të cilave Suedia ka arritur suksesin që e gëzon sot. Si një praktikë suksesi, Kosova ka rastin e analizimit të procesit dhe shfrytëzimit të përvojave drejt arritjes së një procesi të suksesshëm të tranzicionit të drejtë energjetik.

Ndotja mbetet ndër shtyllat më sfiduese të Agjendës së Gjelbër. Kosova ka shënuar pak progres në ndalimin e ndotjes së ajrit, menaxhimit të ujit dhe menaxhimit të tokave. Kjo si pasojë e ngecjes në shumë procese, politikës së gabuar dhe mos ofrimit të zgjidhjeve adekuate për qytetarët. Gjithashtu, krijimi i kushteve të dobëta të tregut ka rezultuar në mos investime të huaja dhe varshmëri nga burimet fosile.

Mekanizmat financiar dhe instrumentet e siguruara nga BE-ja ndihmojnë shtetet drejt tranzicionit të drejtë. Kosova gjithashtu mund të përfitojë nga këto fonde, duke bërë kështu të përballueshëm një proces të tillë. Qasja e BE-së ndaj tranzicionit, tregon udhën të cilën ka vendosur të ndjek BE dhe udhën që pret nga shtetet e saj anëtare dhe atyre që synojnë të jenë në të ardhmen anëtare të saj. Andaj, qasja në këto mekanizma financiare kontribuon në arritjen e objektivave karshi mjedisit dhe në gjelbërimin e sektorit karshi mos ndikimit social tek familjet kosovare.

## Rekomandime

1. Kosova të definoj tranzicionin e drejtë përmes Strategjisë së Energjisë dhe pakove të legjislacionit në fushën e energjisë veçanërisht Ligjit për Energjinë, Ligjit për Eficiencën e Energjisë dhe Ligjit për Burimet e Ripërtrishme të Energjisë. Definimi i termit “tranzicion i drejtë” duhet të bëhet në atë mënyrë që të përfshijë mos lënjen e askujt prapa, karakterin ndër-sektorial të tij dhe të përfshijë elemente të ruajtjes së kohezionit social, transformimit të aftësive punëtore dhe mbrojtjes së grupeve të cenueshme.
2. Qeveria e Kosovës duhet të hartojë plane dhe strategji të investimeve të reja në sektorin e energjisë të cilat duhet të ndërlidhen me një set kriteresh që promovojnë tranzicionin e drejtë. Investimet në sektorin e energjisë duhet të bëhen paralelisht me mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm dhe ruajtjen e mirëqenies së fuqisë punëtore dhe përgatitjen e profesioneve të reja.
3. Të bëhet harmonizimi i strategjive që lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e tij, e gjithashtu i politikave që shtyjnë përpara procesin e tranzicionit të drejtë energjetik. Krijimi i lehtësimeve përmes këtyre pikave paraqet bazë të rëndësishme për të shtyrë përpara transformimin e sektorit të energjisë dhe digjitalizimin e tij. Në të njëjtën kohë, krijohen lehtësime dhe qartësi edhe për qytetarët pjesëmarrës, institucionet, bizneset dhe investitorët e huaj. Nevojitet një hierarki e qartë e strategjive dhe e bazës ligjore në mënyrë që parimet e tranzicionit të drejtë të zbatohen në të gjithë sektorët dhe pa diskrepanca në zbatim.
4. Të stimulohen masat e eficiencës së energjisë. Krijimi i lehtësimeve, stimulimi me të holla apo përmes kredive të buta, bashkëfinancimit apo metodave tjera që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve shtëpiake, e të cilat direkt ndikojnë në zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike , janë disa nga masat që Qeveria e Kosovës duhet të aplikojë në raport me qytetarët apo bizneset. Programet e eficiencës duhet të ndërlidhen me statusin e konsumatorëve në tranzicionin e energjisë, një instrument ky që do mundësojë tranzicionin e drejtë dhe gjithëpërfshirjen në proces. Gjithashtu, përmes këtij instrumenti, do të mundësohet luftimi i varfërisë energjetike dhe mbrojtja e konsumatorëve.
5. Qeveria e Kosovës të alokojë mjete për mbështetjen e investimeve në burime të ripërtrishme nga ana e konsumatorëve. Këto projekte do të ndikojnë drejtpërdrejtë në uljen e nevojës për konsum dhe garantimin e gjithëpërfshirjes në proces. Skema duhet të ndërlidhet me programin e konsumatorëve në nevojë dhe të prioritetizoj uljen e kërkesës për energji pikërisht tek grupet që më së shumti cenohen nga tranzicioni. Shtimi i kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike, siguria energjetike dhe tranzicioni energjetik janë vetëm disa nga benefitet e projekteve të tilla.
6. Kosova të marrë shembull Suedinë dhe rrugën e saj drejt tranzicionit energjetik. Modeli i tregut të tanishëm të Suedisë është shembull i mirë se si tranzicioni duhet të ndërlidhet mirëqenien sociale me transformimin e sektorit të energjisë, duke krijuar vende të reja të

punës dhe duke bërë të mundur prodhimin e energjisë elektrike përmes burimeve që nuk emetojnë gazra serrë. Me modelin e tregut suedez, do të mund të përfitonim nga përvoja duke rritur krahas kësaj edhe transparencën dhe shkëmbimin e të dhënave në përgjithësi.

7. Qeveria e Kosovës të fillojë bisedimet me institucionet si Banka Evropiane e Investimeve, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës, Banka Botërore, e gjithashtu të sigurojë fonde dhe grante nga instrumentet financiare të Bashkimit Evropian si IPA III dhe Fondi i Gjellbër i Klimës. Janë këto mekanizma financiar ata që lehtësojnë dhe mundësojnë përmbushjen e procesit të tranzicionit të drejtë për vendet në zhvillim si Kosova. Një plan i përgjithshëm i investimeve duhet të miratohet krahas miratimit të Strategjisë së re të Energjisë i cili plan do të mundësonte efikasitet më të madh në absorbimin e fondeve dhe zbatimin e tyre.
8. Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë përgjegjëse për qendrat e aftësisimit profesional, të hartojnë Programin për Riorientim dhe Riaftësim për profesionet e gjelbra. Me këtë, punonjësit do të riaftësoheshin dhe do të siguroheshin vendet e reja të punës që të kenë kushte të mira, veçanërisht në industritë e gjelbërta në zhvillim. Sigurimi i vendeve të punës do të thoshte përkushtim ndaj qështjeve sociale dhe ndikimit që tranzicioni do të mund të kishte tek individët që kryejnë aktivitetet e tyre në industri ndotëse. Gjithpërfshirja është një nga parimet kryesore të tranzicionit të drejtë, andaj Qeveria e Kosovës së bashku me partnerët e saj të brendshëm dhe të jashtëm duhet të hartojnë strategji të punësimit në linjë me zëvendësimin e pozitive të industrive aktuale emetuese të gazrave serrë.
9. Të intensifikohen përpjekjet për krijim të tregut rajonal të energjisë. Tregjet e përbashkëta të energjisë tashmë kanë dëshmuar të jenë të suksesshme, andaj në procese transformuese të energjisë, japin kontribut të jashtëzakonshëm lehtësues. Fillimisht me Shqipërinë e pastaj Qeveria e Kosovës të shqyrtojë edhe mundësitë e bashkimit me vendet e tjera rajonale, për stabilizim të rritjes energjetik dhe për përshtetshmëri të transformimit.
10. Qeveria e Kosovës të miratojë gjatë vitit 2022 pakon e gjelbër të legjislacionit për energji përfshirë Ligjin për Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, Strategjinë e Dekarbonizimit si dhe Planet Komonale për Energji dhe Klimë. Në të njëjtën kohë, të bëhet harmonizimi i këtyre dokumenteve me Strategjinë e Energjisë 2022-2031, në mënyrë që objektivat strategjik të përmbushen dhe të arrihet përmirësim i situatës aktuale. Miratimi në kohë dhe pa vonesa i pakos së legjislacionit të energjisë do të mundësonte edhe vëmendje më të shtuar dhe në kohë për tranzicionin energjetik dhe komponentën “e drejtë” të tij.

